



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr.1003/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtaret: Zyhdi Haziri kryesuese, Kymete Kicaj dhe Adnan Konoshevcu anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë Ilir Zuka nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Viti paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

## **V E N D I M**

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.1003/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë Ilir Zuka nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Viti, më të cilat kërkon rinumërimin e votave në Qendrat e Votimit 2625D, 2610D, 2633D dhe 2608D në Viti.

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë Ilir Zuka nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Viti, në të cilën kërkon rinumërimin e votave në qendrat e votimit 2625D, 2610D, 2633D dhe 2608D në Viti.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

**Apeli është i pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë Ilir Zuka nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Viti, ka paraqitur apel me të cilën kërkon rinumërimin e votave në qendrat e votimit 2625D, 2610D, 2633D dhe 2608D në Viti.

Paneli, vlerëson se parashtuesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Anr.1003/2021 më datën 07.11.2021.**

**Kryesues i Panelit**  
**Zyhdi Haziri**



***Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.*